24 SHTATOR 1966
DITA E DËBIMIT POLITIK TË FAMILJES BAJRAM ZEQIR BERISHA



24 SHTATOR 1966 – 2025
NË KËTË SHTËPI U STREHUAM NATËN E PARË TË DËBIMIT TONË POLITIK.

TROPOJË – GRYKE - DROJË – 24 SHTATOR 1966

Trembëdhjetë vetë, të rrëmbyer nga Sigurimi i Shtetit, pasi ishim nisur një pasdite më parë – më 23 shtator – nga Tropoja e Vjetër, mbërritëm në bonifikim, në një vend që kurrë nuk e kishim dëgjuar: Gryka e Drojës – Shpërdhet – Mamurras, në rrethin e Krujës.

Shtëpia që shihni në foto u bë streha jonë, të cilën na e hapën me zemër Dervish Zenel Dervishi dhe zonja e tij, Zoje Dervishi.

Shpirti iu bëftë dritë në parajsë!

Ajo shtëpi, e cila ende qëndron në këmbë, na mbajti afro dy vjet. Ne ishim mysafirët e bujarëve Dervishi dhe të dëbuarit e asaj kohe.

Nderim për atë familje të madhe!

E kaluara që harrohet, rrezikon të përsëritet.

MË POSHTË PO JAP DISA NGA KOMENTET DHE PËRGJIGJET LIDHUR ME KËTË POSTIM NË FAQEN TIME NË FB, MË DATË 24 SHTATOR 2025.

MEREME PARRUCA – ISH-SEKRETARE E KOMITETIT EKZEKUTIV TË RRETHIT TË KRUJËS NË VITET '80.

I nderuar z. Mal,

Mirënjohja është vlerë.

Nuk është thjesht një falënderim, por një ndjenjë, një respekt për atë që të dha dorën e ndihmën, që të fali dashuri pikërisht kur kishe nevojë. Në këtë rast, bëhet fjalë për familjen e nderuar dhe të respektuar **Dervishi**, së cilës i uroj gjithë të mirat.

Sinqerisht, nuk e kam ditur historinë e familjes suaj.

Na ka lidhur puna, por kurrë nuk është hapur ky muhabet.

Më beso, ndjej keqardhje.

Ju kam njohur në mesin e viteve '80.

Dhe kur lexoj ato që keni shkruar, mendoj se ju dhe shumë të tjerë — të cilëve jeta u ka sjellë nga më të ndryshmet pikëllime e vuajtje shpirtërore, ekonomike

etj. — i keni shndërruar këto vuajtje në forcë, përkushtim, sakrificë, ndershmëri, dashuri dhe respekt për punën dhe për njerëzit rreth jush.
Besoj më kuptoni ku e kam fjalën. Kështu ju kam njohur dhe kështu do t'ju kujtoj gjithmonë.
E njëjta gjë vlen edhe për mikën tonë të përbashkët, **Adelina Shehu Hoxha**.
Do t'ju kujtoj gjithnjë si persona që iu përkushtuat pa mëdyshje detyrës së besuar në fushën e mësimdhënies, artit dhe kulturës në rreth, veçanërisht në qytetet përkatëse Krujë e Laç.
Respekt për ju dhe familjen tuaj.
Ju uroj shëndet dhe mbarësi!
Mereme

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA
Shumë e nderuar zonja Parruca!
Më nxitët të bëj një sqarim që besoj se ia vlen.
Mesazhi juaj, përveçse më gëzon që më keni kujtuar si njerëz që kemi respektuar njëri-tjetrin si në pozitat zyrtare ashtu edhe në ato njerëzore, më jep mundësinë të shprehem se ju ishit një ndër zyrtaret më të rëndësishme shtetërore–lokale të atyre viteve që ju

përmendni, në detyrën e Sekretares së Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Krujë.

Mirësia juaj paskërka qëndruar, përveç të tjerash, edhe në faktin se ju nuk keni “gërmuar” në biografinë tonë, timen por edhe të një artisteje që u bë njësh me Krujën, zonjës Adelina Hoxha–Shehu, siç mund të bënin – dhe bënin në fakt – shumë të tjerë.

Megjithatë, kurrë nuk u treguat autoritare apo e tillë që të na e bënit punën më të vështirë; përkundrazi, na e lehtësuat atë.

Në fakt, nëse nuk gaboj, ju pasuat në zyrë një zonjë tjetër shumë të nderuar, zonjën Tefta Komnino, e cila po ashtu na trajtoi si njerëz punëtorë dhe të ndershëm, pa na prekur në “pikën tonë të dobët”. Përkrah jush punonte një zonjë tjetër krutane po ashtu shumë e nderuar, Lule Berani - Seseri, Shefe e Arsimit dhe Kulturës, “kosovarja” e natyralizuar, e martuar me mësuesin e nderuar nga Drenica e Kosovës, Ramadan Berani . Ju i jepnit atyre zyrave një pamje që unë tani e quaj “SOFT POWER” të punës sonë të asaj kohe.

Në të vërtetë, jo çdo gjë që i ndodh njeriut, i ndodh për keq. Shumë kohë përpara se ju të vinit në atë detyrë, një krutan tjetër — për të cilin shumëkush mund të ketë

vlerësimet e veta, të mira apo të këqija — është ai që i dha tehun e mbarë jetës sime.

Ai ishte Hamit Taga, shpirti i bëftë dritë!

Në vitin 1971, unë mbarova gjimnazin e Laçit, i cili ishte hapur në vitin 1967 dhe ku për regjistrim nuk kërkoheshin kushte politike apo biografike. E përfundova me shumë vështirësi, duke udhëtuar çdo ditë në distancën Mamurras–Laç 10 klm. Në atë kohë, çështja e arsimimit tim të lartë u bë një problem madhor për familjen tonë.

Të drejtat e studimit për gjimnazistët e Krujës, Fushë-Krujës dhe Laçit u ndanë atë verë të vitit 1971, por natyrisht emri im nuk figuronte askund. Atëherë, një mundësi që Hamit Taga — në atë kohë Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Krujë — u dha prindërve të mi për t'u ankuar dhe për t'u sqaruar, u bë momenti i artë i jetës sime.

Ai i priti me atë skrupulozitet që e karakterizonte dhe iu tha hapur:

"Djali juaj është bir i një familjeje të deklasuar dhe nuk meriton të shkojë në shkollë të lartë."

Nëna ime, një malësore këmbëngulëse e vendosur, i kërkoi sqarime se çfarë klase të përmbysur mund të përfaqësoja unë, një djalosh 18-vjeçar!?
Ai u tha se dosja e përcjellë nga vendlindja ime kishte aq shumë elementë politikë “anti-parti”, saqë ne duhej të ishim “të lumtur” që ende na lejohej të punonim në orizoret e fermës së Thumanës në Paraqat. Shtesat dashakeqe nga një dorë e zezë, në atë dosje ishin të tilla, sa nuk kishte zyrtar të atij shteti që mund të guxonte të më jepte mua të drejtë studimi.
Kjo bëri që prindërit e mi të mësonin se, përveç një “të keqeje” që vërtet e kishim në biografi, ishin shtuar edhe disa elementë të tjerë të shpifur, të cilët e bënin të pamundur vijimin tim në shkollë të lartë.
Në këtë rast, prindërit e mi “zbuluan” diçka për vetveten e tyre që kurrë më parë nuk e kishin parë, bërë apo dëgjuar – diçka që kurrë nuk kishte ndodhur dhe që na mundonte me përndjekje krejtësisht të paarsyeshme dhe tërësisht disproporcionale me atë që po vuanim…!?
Përpara atij Kryetari autoritar, ata insistuan me ngulm, me pasion dhe me dëshpërim, duke e theksuar se ato

që thuheshin në atë dosje nuk ishin aspak të vërteta. Pas atij "debati", Hamit Taga u tha prerë:

"Nëse këto që kam unë këtu në dosje verifikohen nga ju me letra zyrtare nga Tropoja se nuk janë të vërteta, unë ju garantoj të drejtën e djalit për shkollim. Por ju nuk do të mundeni sepse partia jonë nuk gënjen asnjëherë...?!"

Fatmirësisht, prindërit e mi qenë aq këmbëngulës sa arritën që, në Bajram Curri — ku gjendeshin edhe njerëz të mirë në ndonjë zyrë — të pastronin dosjen nga shpifjet dhe ia sollën plikon me stampa zifti Hamit Tagës dorazi. Ai, si një burrë krutan i vërtetë, pasi e pa dosjen, e mbajti fjalën. Dhe unë... u lejova të shkollohesha në Institutin e Lartë të Arteve po atë vit dhe mora rrugën që tashmë dihet.

Prandaj, Zenel Dervishët e Drojës – Shpërdhet – Mamurras; Hamit Tagët, Parrucët, Seferët... dhe sa e sa të tjerë që i njoha, i desha dhe më deshën, i dua dhe nuk i harroj kurrë. Ata, vete Juve zonja Mereme, , më bëjnë që, si malësor krenar nga Malësia e Gjakovës, Krujën ta dua me gjithë shpirt - Jo vetëm për Skënderbeun dhe Kalanë, por edhe për hir të njerëzve të mrekullueshëm

me të cilët më ka lidhur puna dhe jeta nga viti 1966 deri në vititn 1992.
Shumëkush mund t'i interpretojë këto ndodhira në mënyrën e vet – unë i vlerësoj si shprehje të mirësisë dhe mirënjohjes njerëzore, pavarësisht nga rrethanat politike.
Respekt për juve personalisht dhe faleminderit që më shkruat!
Shënim: Pas çdo njeriu qëndron gjithmonë një histori.
Lum ai që e vetëshkruan atë me nder!

MEREME PARRUCA

I nderuar z. Mal Berisha
Ju falënderoj shumë që gjetët kohën të më shkruani. Ju kuptoj shumë mirë për gjithçka keni sqaruar. Shumë nga emrat që keni përmendur dhe për të cilët flisni me kaq respekt, e me të drejtë u jeni mirënjohës, unë i kam njohur pasi më ka lidhur puna me ta. Ruaj të njëjtin mendim. Për këtë edhe njëherë ju përgëzoj.
Nuk mund të ndodhte ndryshe për aq sa ju kam njohur. Keni qenë dhe mbeteni njeri me karakter të fortë e të lartë. Unë, sa kam mundur, jam përpjekur t'i njoh vetë njerëzit me të cilët më është dashur të punoj.

Nuk jam nisur nga fakti se çfarë thonë të tjerët dhe nuk kam kërkuar të rrëmoj në jetën e tyre. Prandaj vitet na bënë miq të mirë.
Uroj shëndet dhe gjithë të mirat.
Të fala znj. Donika.

ADELINA SHEHU HOXHA

Z. Mal Berisha,
Kur lexova historinë tuaj në këtë status, pashë pika të tjera bashkimi në jetët tona profesionale me të njëjtët personazhe dhe me dashamirësinë e drejtuesve, kolegëve dhe qytetarëve të Krujës. Ju përgëzoj për vërtetësinë e tregimit tuaj, të cilin e kisha dëgjuar rreth 13 vjet më parë.
Dihet se Kruja ishte një vend që nuk iu nda besimit në Zot dhe ku "lufta e klasave" qe më e butë se në çdo vend tjetër të tokës shqiptare. Prandaj, ne punuam qetë, me pasion dhe morëm vlerësimin e dëshiruar. Shumë gjëra për mirënjohjen ndaj tyre nuk kemi arritur t'i themi me zë të lartë, por falë teknologjisë kjo tashmë po mundësohet.
Respekt për ju dhe punën tuaj, si edhe për të gjithë ata që na mundësuan të shpalosim vlerat tona!

MUHARREM FERHATI

I nderuar z. Mal!

E kujtoj si në mjegull këtë periudhë. Në Shpërdhet janë dajat e babës tim: Haxhi Dervishi, Rrem Dervishi, Dervish Dervishi, dhe i pari i fisit, Zenel Dervishi.

Familje të nderuara dhe të respektuara.

Gati çdo verë shkonim tek dajat e babës, laheshim në Drojë, etj. E kujtoj këtë kohë, sepse flitej për ju si familje e dëbuar, por unë dija se kishit ardhur nga trevat shqiptare të Malit të Zi. Për ju kishin respekt.

Ky ishte regjimi dhe këto situata kemi përjetuar. Respekte për ju dhe për fisin Dervishi në Shpërdhet.

Mirënjohja është virtyt.

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

I dashur Dr. Muharremi! I kam njohur thuajse te gjithe, jo aq kur isha femije por edhe me vone sepse ne i ruajtem mardhenjet me familjet Dervishi si dhe te Dyl Sheferit dhe te familjes me ne krye te Drojes, tek ullinjte, Aliaj. Ju falenderoj per mesazhin dhe tani e

kuptoj edhe me mire fisnikerine tuaj qe vjen edhe nga dajallaret. Te fala me respekt, Mali.

ZEF PERVIZI

Mal Berisha, E kam jetuar Drojën, xhaminë dhe gjithçka që lidhej me të, sepse në ato vite kam qenë mësues në atë vend.
Në sheshin para ndërtesës, shkonim grup shokësh e shoqesh mësues; me varfërinë tonë hanim bukë e djathë, shoqëruar me pak muzikë nga radioja e Durrësit.
Familja e Bajram Berishës ka kaluar dy tmerre: jetën e vështirë dhe punën në Paraqad, disa kilometra rrugë larg.
Të jetosh, Mal Berisha, është fat i madh, sepse fatit e Zotit nuk i del kush përpara.
Unë, në vitet 1947–1952, përjetova internimin në Tepelenë.
Në vitin 1961 mbarova Pedagogjiken dhe u bëra mësues – Hysen Kuqi, F. Mamurras – krenar që isha i vetmi mësues me arsim profesional. Pedagogjiken e përfundova me Shejnaze Jukën në Shkodër.

Kjo është jeta: nga Drojë e mjerë, deri në diplomacinë shqiptare – Berisha ambasador në Londër, Skoci, Irlandë, Islandë, Gjermani dhe, mbi gjithçka, në Kalabrinë shqiptare.
Të gjitha këto janë dhuratë e fatit.
E nderoj Profesorin, z. Sali Berisha.
Paçi jetë të gjatë!

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

Zef Pervizi Shume i dashur zotni Pervizi! Ju falenderoj nga zemra per komentin! Vuejtjet harrohen, po e ardhmja nuk e di se ku po na con. Te fala me respekt.

ROZI DAKO

Në periudha të vështira, kur errësira e persekutimit rëndonte mbi shumë familje shqiptare, disa shtëpi u bënë dritë shprese dhe mbrojtjeje. Ishin familje të guximshme, me një traditë të fortë atdhedashurie dhe besnikërie ndaj vlerave njerëzore, që u ngritën si mburojë për ata që rrezikoheshin vetëm pse kishin ideale, emër apo qëndrim ndryshe.
Ndër këto familje fisnike ishte edhe ajo e **Luarasëve**, e cila tregoi kurajë, mirësi dhe solidaritet në një kohë kur

frika shpesh kishte zëvendësuar njerëzoren, duke mbrojtur me dinjitet familjen tonë **Dako–Qiriazi**.

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

A friend in need is a friend indeed.

Miku njihet që është mik, në të ngushtë e në rrezik.

Por ai mik që rrezikon për veten, ose të ndihmon pa asnjë interes e pa asnjë njohje të mëparshme, si në rastin tim, ai është modeli i vërtetë i mirësisë njerëzore. Respekt për Luarasët dhe për ju, Dakot, Qiriazët dhe patriotët e farë e fisit tuaj!

AMBASADOR FLAMUR GASHI

I dashur **Mal**,

Para dy ditesh e kam kujtuar ne bisede me nje mik, historine e shkuarjes se familjes tuaj ne Teqen e Drojes siç ma ke tregu ti vite me pare, si dhe emrin e Qazim Vrages dhe dy cigaret e tij per Dervishin e Teqes...

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

Flamur Gashi I dashur Ambasador Gashi! Ndodhin gjera ne jete qe pikerisht dy cigare duhani ia nderrojne jeten jo nje individi por edhe nje familje. Ai amanet i

dajes tuaj Qazim Vraga per Dervishin Zenel Dervishi na e zgjidhi ne ate kohe problemin me jetik: Strehimin. I jam perhere mirenjohes atij burri, Qazim Vrages dhe emrit te tij qe u be garant tek Dervishi per familjen tone. Me vone une e gjeta veten ne klase me nipin e Zenelit **Agim Dervishi** me te cilin u beme shoke dhe e mbajme ate edhe sot.Nderime!

JORDAN DACI

E tmerrshme sesi, ende sot, plagët e komunizmit nuk po shërohen. Dhe më e keqja: Shqipëria vazhdon të kontrollohet masivisht nga ish-funksionarë apo pinjollë të kriminelëve të regjimit fashisto–komunist!

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

Jordan Daci, i dashur zotni Jordan! Po t'ju tregoja se pikërisht i biri i atij që kishte firmosur urdhrin e dëbimit politik të familjes sime ishte superiori im dhe një nga njerëzit më të rëndësishëm të qeverive shqiptare pas vitit 2013… ju besoj se nuk do të habiteni!

ELIDA VASO

Një popull që harron historinë rrezikon që ajo të

përsëritet... Kam harruar kush e ka thënë. Populli ynë e ka memorien të shkurtër. Ndoshta kjo e ka ndihmuar të mbijetojë... Nëna ime ka provuar internimin.
Të përqafoj, Mal Berisha.

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

Elida Vaso, *"Forgive but not forget"*, e dashur Elida! Jemi shumë që kemi histori të tilla – habia më e madhe është kur sheh që ka njerëz (madje edhe në këtë komunikim social) që na bëjnë me faj, vetëm pse kemi mbijetuar, pse jemi gjallë, pse jemi bërë me shkollë, pse në vitet e demokracisë kemi arritur të kontribuojmë për vendin tonë.
Edhe unë të përqafoj me respekt dhe shumë të fala Nisidës tënde të mrekullueshme!

ISA ZYMBERI

Një copëz nga mijëra e mijëra kujtimesh të trishta pothuaj të harruara, që shumëkujt sot, fatkeqësisht, u duken si përralla. Tash të djathtët përballen me tortura moderne!

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

Isa Zymberi I dashur zotni Zymberi! Historia ime eshte nje nder me te thjeshtat e asaj kohe. Por une e kujtoj perhere, pasi besoj se Pas cdo qenje njerezore "fshihet" nje histori. Mbetem me respekt per juve si perhere juaji Mali Te fala shume miqeve tane ne Londer!

ELJONA DERVISHI

Kete histori e tregon gjithmone babi Zenel Dervishi,sesi gjyshi im jua ka hapur deren
Respekte per ju Mal Berisha

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

Eljona Dervishi Faleminderit Eljona, jeni familje e nderuar, jo vetem prej gjesitit te gjyshit tuaj, por per shume veti te tjera qe i keni manifestuar nder dekada. Te fala shume, Mali

AGIM DERVISHI

Më vjen mirë që i kujton ato vite dhe gjyshin me gjyshen tonë. Të marrësh një familje vetëm me rrobat e trupit dhe ta hedhësh në rrugë, atje ku nuk njeh asnjë njeri, është e paharrueshme. Këtu qëndron mirësia e gjyshit. Respekte për familjen tuaj.

PËRGJIGJE NGA MAL BERISHA

Agim Dervishi I dashur Gimi! Pas asaj ngjarje neve u rritem bashke, madje na takoi qe edhe te punonim bashke dhe perhere mbetem njerez te dashur e te respektuar - kjo ngjarje ,e Zenel dhe Zoje Dervishin na lidhte shume me shume neve sesa me te tjeret. Te dergojme te fala nga te gjithe e vecnerisht nga 96 vjecarja, nena ime qe ishte grua e re ne ate kohe qe po flasim. Respekte e te fala shume!